



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agjencia Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 11/09/2020 Ref.: 1575/20

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 83-të, të mbajtur më 02.09.2020, mori:

V E N D I M

- I. Validohet programi i studimit i RIT Kosovo (A.U.K.) College për periudhën 1 Tetor 2020 – 31 Shtator 2023:
 - Informatikë dhe Teknologjitë Informative, BSc, 240 ECTS, maksimum 50 studentë për vit akademik
- II. Obligohet RIT Kosovo (A.U.K.) College që deri me datë 31 Tetor 2020 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. RIT Kosovo (A.U.K.) College ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për validim të programit të studimit të cekur në dispozitivin I të këtij vendimi. Vendimi është marrë në bazë të certifikatave dhe dëshmimeve të ofruara, rreth akreditimit dhe validimit të këtij institucioni nga agjencia "The

Middle States Commission on Higher Education”, e cila është anëtare e Komitetit të Arsimit të Lartë (CHEA) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- RIT Kosovo (A.U.K.)
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.



G. Luboteni

Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë